

volumi 2, numri 3
vjeshta 2004

Zëri i

Gruas Kosovare

Përmbajtja

- 2 Grupet Përkrahëse të Nënave që Ushqejnë me Qumësht të Gjirit
- 2 Shënimet nga Takimi i Rrjetit në Shtator
- 3 Plani Strategjik i RRGK-së
- 3 Fushata "Dil e Voto"
- 3 Iniciativa e "Parlamentit të Vajzave"
- 4 UNDP Promovon Raporin e Dytë për Zhvillim Njerëzor në Kosovë

Njohtimet

25 nëntor, Pejë
Qendra për Mirëqenjen e Gruas organizon Ditën e Fjongsës së Bardhë

29 nëntor, Prishtinë,
Teatri ODA, 20:00
RRGGK fillon fushatën "Të Njohim të Drejtat"

29-30 nëntor
Gratë nga Bosnia dhe Hercegovina vizitojnë OJQ-të kosovare të grave

4 dhjetor, Prishtinë
Takimi Vjetor i RRGK-së

7 shkurt, Prishtinë, HCIC, 11:00
Takimi i rregullt i RRGK-së

RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS



www.womensnetwork.org

Kosovarët Diskutojnë mbi Mekanizmat e Barazisë Gjinore

Konferenca mbi Mekanizmat e Barazisë Gjinore ishte një iniciativë e përbashkët e organizuar nga zyra e Kryeministrit, Zyra Këshillimore për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Çështjet Gjinore (AOGG), Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK), Departamenti i Demokratizimit të OSBE-së, UNIFEM dhe Zyra për Çështje Gjinore e UNIMK-ut (OGA).

Konferenca u organizua në kontekstin e Ligjit të ri për Barazinë Gjinore. Në përgatitje të konferencës u krijua një forum avokuesish dhe ekspertësh të përfshirë në përparimin e barazisë gjinore në Kosovë në nivel qendror dhe lokal. Ky forum punoi për të analizuar mekanizmat egzistues të barazisë gjinore në Kosovë dhe për të diskutuar ndryshimet ose veprimet që janë të nevojshme në mënyrë që të institucionalizohen dhe të fuqizohen avokuesit për barazi gjinore.

Partnerët ndërkombëtarë, të cilët mbështetën këtë konferencë, kanë qenë të përfshirë në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve egzistuese për barazinë gjinore në Kosovë.

Fushata që Bashkon Gratë, Politikanët dhe Votuesit

Më 21 shtator RRGK filloi fazën e dytë të kësaj fushatë me një konferencë për shtyp në ndërtesën e OSBE-së. Pjesëmarrësit në konferencë diskutuan çështjet se si të zbatohet



Konferenca mbi Mekanizmat për Barazinë Gjinore është mbajtur në Grand Hotel në Prishtinë, më 17 dhe 18 Shtator.

Mbështetja e tyre për këtë konferencë tregon një angazhim të vazhdueshëm për të dhënë ndihmë dhe këshilla për arritjen e barazisë gjinore këtu. Me ndihmën e tyre Kosova po përparon me zbatimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore dhe të Ligjit të ri për Barazi Gjinore.

Objektivat e Konferencës mbi Mekanizmat për Barazinë Gjinore ishin:

1. Të krijohet një forum, në të cilin të debatohet dhe të analizohen mekanizmat egzistues për arritjen e barazisë gjinore në nivel lokal dhe qendror. Kjo në ndërlidhje gjithmonë me Ligjin e Barazisë Gjinore. Të analizohen eksperiencat e fitu-

ara nga funksionimi aktual i mekanizmave të barazisë gjinore dhe të merret përvojë nga eksperiencia e grupeve të grave të Europës.

2. Të forcohen mekanizmat e barazisë në nivel qendror dhe komunal, si dhe të rritet niveli i koordinimit të tyre.

3. Të diskutohen praktikat legislative dhe masat praktike, të cilat janë të nevojshme për zbatimin e Ligjit mbi Barazinë Gjinore në Kosovë. Të nxirren rekomandime dhe udhëzime për të zbatuar ligjin e sipërpërmendur.

Rekomandimet nga konferenca do të publikohen në numrin e ardhshëm të "Zërit të Gruas Kosovare".

në mënyrë sa më efektive shpërndarja e informacionit për këtë fushatë në mënyrë që të inkurajohet sa më shumë pjesëmarrja e femrave në politikë. RRGK-ja punësoi një Koordinatorë të re të Fushatës, Violeta Selimi, dhe i uroi asaj një mirëseardhje të ngrohtë.

Fushata është përkrahur nga OSBE-ja dhe Zyra Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SCDO), me asistencë teknike të STAR Netëork dhe UNIFEM-it.

Fushata "Gratë Propozojnë", një përpjekje e RRGK-së për të ngritur shkallën e pjesëmarrjes së grave në politikë, ka arritur shumë nga objektivat e formuluar gjatë muajve të verës në përgatitje të zgjedhjeve që po afroreshin. Politikanet kandiduese u takuan me votuesit nga 30 komuna të ndryshme. Votuesit patën mundësinë t'i shprehin shqetësimet e tyre drejt për së drejti kandidatëve femra. Kandidatet patën mundësinë të bëjnë të njohur emrat e tyre dhe të shpjegojnë platformën e tyre politike.



Violeta Selimi, Koordinatorja e fushatës Gratë Propozojnë, udhëheq diskutimet në takimin në Prishtinë.

Shënimet nga Takimi i Rrjetit në shtator

• Projekti "Grupet përkrahëse të nënave që ushqejnë me qumësht të gjirit" do të fillojë në tetor të vitit 2004 dhe do të zgjasë për gjashtë muaj. Projekti do të zbatohet nga RRGK dhe do të financohet nga UNICEF.

• Projekti "Iniciativa e Parlamentit të Vajzave" është në procesin e finalizimit, është planifikuar të fillojë në dhjetor të 2004 dhe të vazhdojë deri në dhjetor të 2005. Do të zbatohet nga "Women Without Borders" (Gratë pa Kufinj /Viena ,Austri) me ndihmesë të RRGK-së dhe anëtarëve të saj.

• Fushata "Gratë Propozojnë" - informim mbi fazën e dytë

• Fushata "Dil dhe Voto" mobilizoi shoqërinë civile për të votuar. Kjo fushatë ishte organizuar nga NDI-ja, ATRC-ja dhe RRGK.

• Njohtim mbi konferencën "Mekanizmat e Barazisë Gjinore në Kosovë", e cila është mbajtur me 17 dhe 18 shtator 2004 në Grand Hotel, Prishtinë.

• "Handikos" ka filluar një iniciativë të re të quajtur "Demokraci për të Gjithë" e cila fokusohet në ndërgjegjësimin e votuesve duke përfshirë edhe individët me aftësi të kufizuara. Kjo organizatë do të përgatisë një program kombëtar, i cili do t'u shpërndahet partive politike, qeverisë dhe të tjerëve.

• Organizata lokale e Gjakovës "Qeliza" ka filluar një projekt "Të Ndhimojmë Votuesit dhe të Votojmë" e financuar nga OSBE

Formohen "Grupet Përkrahëse të Nënave që Ushqejnë me Qumësht të Gjirit"

RRGK-ja në bashkëpunim me UNICEF-in, me grupin e punës të spitaleve "Mike të Foshnjës" dhe OJQ-të lokale është duke zbatuar një projekt, i cili ka për qëllim të rrisë nivelin e të ushqyerit ekskluzivisht me qumësht të gjirit tek fëmijët. Kjo do të arrihet me formimin e Grupeve Përkrahëse të Nënave që Ushqejnë me Qumësht të Gjirit në gjashtë komuna të ndryshme. Këto grupe përkrahëse, pikë së pari, do të mbështesin, mbrojnë, dhe promovojnë të ushqyerit me gjirë në nivel komuniteti. Këto grupe përkrahëse do të organizohen nga organizatat lokale të grave, të cilat janë të familjarizuara me zonat e caktuara, në mënyrë që të sigurohet suksesi i projektit. Projekti do të mbajë një bashkëpunim të ngushtë me institucione shëndetësore dhe me grupin e punës të spitaleve "Mike të Foshnjës" dhe në këtë mënyrë do të jetë në gjendje të mbështesë përafshisht 4000 nëna me prejardhje të ndryshme etnike.

Rreth 4000 nëna të etniciteteve të ndryshme do të përfitojnë nga Grupet Përkrahëse të Nënave që Ushqejnë me Qumësht të Gjirit

Grupet Përkrahëse të Nënave që Ushqejnë me Qumësht të Gjirit do të jenë përgjegjëse për aktivitetet që vijojnë:

1. Të mbështesin dhe promovojnë të ushqyerit me gjirë për foshnjat nga lindja deri në moshën 2-vjeçare, me theks të veçantë në të ushqyerit ekskluzivisht me gjirë në gjashtë muajt e parë të jetës.

2. Të krijojnë dhe të mbajnë marrëdhënie të ngushta me maternitetet, në mënyrë që të mbledhin sa më shumë informacione për nënat e reja dhe, nëse është e nevojshme, t'u bëjnë atyre



Fushata Gratë përkrahin Gratë, do t'ju ndihmojë nënave të reja.

edhe vizita në shtëpi.

3. Në qendrat e OJQ-ve, nëpërmjet telefonit dhe konsultave e vizitave nëpër familje, të avokohet, informohen dhe konsultohen nënat, gratë dhe anëtarët e familjeve për sa i përket rëndësisë së të ushqyerit me qumësht të gjirit, si dhe mbi përkujdesjen ndaj qumështit të gjirit.

4. T'u ofrohen nënave informacione dhe konsultime mbi të ushqyerit me qumësht të gjirit, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë nënave me prejardhje nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, si dhe grave që jetojnë në kushte të vështira në zona të caktuara.

5. Nëpërmjet RRGK-së dhe qendrës koordinuese të OJQ-ve të mbahen marrëdhënie sa më të ngushta me institucionet shëndetësore dhe grupin e punës së spitaleve "Mike të Foshnjës".

6. Të mbahen evidenca të rregullta mbi aktivitetet duke përgatitur rregullisht raporte që duhet të ndahen me partnerët.

RRGK do të jetë organizata kryesore përgjegjëse për zbatimin e këtij projekti. Përzgjedhja paraprake e vendeve ku do të zbatohet projekti, u bë në koordinim me UNICEF dhe Grupin e

Punës të spitaleve "Mike të Foshnjës". Këto zona janë qytetet Gjakova, Prizren, Gjilan, Drenas, Pejë dhe Ferizaj. Qendra kryesore e koordinimit do të jetë në Prishtinë. Mbas u bë një konsultim me UNICEF-in dhe Grupin e Punës të spitaleve "Mike të Foshnjës" të Kosovës, RRGK-ja filloi punën për formimin e Grupeve Përkrahëse të Nënave që Ushqejnë me Qumësht të Gjirit në gjashtë komunat e sipërmendura duke përbushur kriteret e përcaktuara. Fillimisht RRGK do të identifikojë personat përgjegjës për këtë projekt duke përfshirë këtu angazhimin në punë të një Koordinatorje të Projektit, si dhe vendosjen e koordinatorëve lokalë dhe asistentë të tjerë, të cilët do të jenë drejtpërsëdrejti përgjegjës për zbatimin e këtij projekti. Më se 40 gra që përfaqësojnë RRGK-në, do të trajnohen për tre ditë për sa i përket këshillimeve mbi të ushqyerit me gjirë.

Pas përfundimit të këtyre trajnimeve ekipet e komunave do të zhvillojnë plane veprimi. UNICEF dhe WHO do të mbështesin trajnimet duke siguruar materiale dhe trajnuesit e certifikuar. Pas një konsultimi me UNICEF-in trajnimet mbi të ushqyerit me gjirë do të pasurohen edhe me fakte të jetës.

Mbas përfundimit të të gjithë projektit RRGK parashikon që grupet përkrahëse të vazhdojnë në baza vullnetare ose të shpërndahen edhe në degë të tjera të shëndetësisë dhe edukimit. Ne shpresojmë që kjo do të na ndihmojë të vendosim bashkëpunim mes grupeve të grave dhe drejtorive shëndetësore të komunave. Projekti do të fillojë në tetor 2004 dhe do të zgjasë gjashtë muaj.



Të ushqyerit me gjirë është më e shëndetshme për nënat dhe fëmijët e tyre

A e keni ditur?

Të ushqyerit me gjirë mund të zvogëlojë rrezikun nga kanceri i gjirit?

Për më shumë informata, vizitoni:
http://www.breastfeeding.com/all_about/all_about_breast_cancer2.html

Koalicioni fillon fushatën "Dil e Voto"

RRGGK në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën e Resurseve dhe Trajnimeve për Avokim (ATRC) dhe Institutin Amerikan Kombëtar për Demokrati-zim (NDI) organizoi një fushatë mbarë-kosovare "Dil Voto" për të inkurajuar pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhjet e 23 tetorit. Fushata "Dil Voto" kishte për qëllim të rrisë moralin dhe ndërgjegjen qytetare për rëndësinë e të votuarit në zgjedhjet e ardhshme nëpërmjet mediave, fletëpalosjeve, posterave dhe lajmërimeve të ndryshme. Tridhjetë koordinatorë të fushatës nga të gjitha komunat rekrutuan dhe trajnuan më shumë se 2200 vullnetarë. Vullnetarët kishin për qëllim të shkojnë në përafërsisht 335.000 shtëpi anë e kënd Kosovës.

Roli i RRGGK ishte që të angazhonte në mënyrë aktive mediat lokale, kështu që fushata të tërhiqte vëmendjen e një numri sa më të madh njerëzish. Anëtarët e RRGGK ftuan figura udhëheqëse të komunitetit të prezantoheshin në biseda televizive, lajme dhe në aktivitete të tjera



Vullnetarët e fushatës Dil e Voto në Prishtinë shpërndajnë pamfleta që tregojnë se sa i rëndësishëm është votimi në zgjedhjet e ardhshme.

mediale. RRGGK dhe koalicioni i fushatës "Dil Voto" besojnë se fushata ishte një sukses, sepse 53% e popullatës doli të votonte përkundër 45% që kishte dalë të votonte në të kaluarën. Shumë prej votuesve u thanë anëtarëve të RRGGK se kishte qenë pikërisht mesazhi në televizion, i cili i kishte bindur ata të votonin. RRGGK u përfshi në këtë fushatë bazuar në rëndësinë shumë të madhe që kishin

këto votime për Kosovën. Duke pasur parasysh edhe bisedat e fundit për sa i përket ardhmërisë së Kosovës dhe statusit të saj politik, këto zgjedhje kishin një domethënie të madhe se kush do ta menaxhojë të ardhmen demokratike të këtij projektorati. Qytetarët dëshmuuan pjekuri duke votuar në një masë të madhe për trupin e ardhshëm qeverisës.

Vazhdon në faqe 4

Iniciativa e "Parlamentit të Vajzave" fillon në Kosovë

RRGGK-ja shpreston të vendos një platformë ndërvepruese në shoqërinë civile, demokracinë dhe çështjet gjinore nga këndvështrimi i gjeneratës së re përmes iniciativës së Parlamentit të Vajzave. Duke përdorur një kuriku-

lum të organizatës "Women Without Borders" (Gratë pa Kufij), vajzat nga mosha 17 deri 20 do të prezantohen me procesin politik dhe shoqërinë civile, në mënyrë që t'u zgjohet interesi në politikën kosovare dhe atë ndërkombëtare. Për t'i dhënë një strukturë të dukshme iniciativës së Parlamentit të Vajzave, kjo iniciativë do të përdorë si model qeverisës atë të Bashkimit Evropian. Tridhjetë vajza nga zona të ndryshme do të trajnohen me një program njëvjeçar. Programi përfshin tre punëtorë, punë në projekte në bashkëpunim me pesë OJQ lokale, udhëtime në dy vende të Bashkimit Evropian, si dhe një prezantim të projektit me përfaqësues të Këshillit të Evropës. Ky projekt nuk do t'u ofrojë vajzave vetëm trajnim teorik, por gjithashtu do t'i aftësojë ato të punojnë së bashku me grupe, të cilat ato nuk kanë pas rastin që t'i takojnë normalisht.



Iniciativa e "Parlamentit të Vajzave" do t'i sjell vajzat një hap më afër rolit të leadershipit në biznes, politikë dhe shoqërisë e së ardhmes.

"Qëllimi ynë është që të formojmë platformë bashkëvepruese edukative për shoqërinë civile, demokraci dhe çështjet gjinore nga perspektiva e gjeneratave të reja"

Për shembull, programi do të nxisë kontakte ndëretnike dhe ndërurbane. Nëpërmjet punëtorëve dhe punës me projekte vajzat do të kenë mundësinë të zhvillojnë aftësi udhëheqëse që pastaj mund t'i përcjellin në brezin e ardhshëm të njerëzve të biznesit, manaxherëve social dhe udhëheqësve politikë. Projekti është planifikuar të fillojë në dhjetor 2004 dhe do të zgjasë një vit. Projekti do të realizohet në bashkëpunim me organizatën "Women Without Borders" nga Austria.

Plani Strategjik i RRGGK

Anëtarët e RRGGK-së dhe partnerët mbajtën mbledhjen e dytë me 24 shtator për të finalizuar planin Strategjik trevjeçar të RRGGK-së, i cili u hartua gjatë pranverës 2004.

Plani strategjik përfshin informacionet që vijojnë:

- Historikun e RRGGK-së
- Analiza e kontekstit politik dhe social, me të cillin përballohet lëvizja e grave kosovare duke përfshirë institucionet e qeverisjes kombëtare dhe ndërkombetare, legjislativonin dhe OJQ-të.
- Analiza e strukturës së RRGGK-së
- Formulimi i objektivave të rëndësishme të RRGGK-së për tre vjetet e ardhshëm
- Përmbledhja e programeve aktuale dhe atyre të ardhshme të RRGGK-së

Plani strategjik u rishikua dhe finalizua në mbledhjen e bordit në muajin tetor.

OJQ-të e grave takohen me aktivistë të të drejtave civile nga SHBA

Me datën 22 shtator përfaqësuese nga OJQ-ve të grave u takuan me Burt Reynolds dhe me dy aktivistë të të drejtave civile nga Shtetet e Bashkuara si dhe me Larry Corwin, Zyr-tari i ri për marrëdhënie me publikun në zyrën e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë (USOP). Ata diskutuan një strategji për të fuqizuar pozitën e gruas në shoqëri si dhe çështjet e tjera të rëndësishme siç ishin marrëdhëniet ndëretnike, Rezoluta e OKB-së 1325 dhe pozicioni i gruas në vendimmarrje.

faqe 4

volumi 2 numri 3

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

www.womensnetwork.org

rrggk_kwn@yahoo.com

Adresa e Re e Zyres!

Agim Ramadani Nr. 50/8
Prishtinë, Kosovë

Stafi i RRGK

Igalle Rogova
Drejtoresha Ekzekutive
igorogova@yahoo.com

Elita Gota
Menaxherja e Programit
elitagota@yahoo.com

Violeta Selimi
Koordinatorja e Fushatës
"Gratë Propozojnë"
vselimi@atoda.org

Laura Ruhi
Koordinatorja e Fushatës
"Gratë përkrasin Gratë"
lauraruhi@yahoo.com

Hatixhe Ramosaj
Menaxherja e Financave
hatixher@hotmail.com

Bordi i RRGK

Naxhije Bucinca
Argjentina Grazhdani
Delina Fico
Flora Macula
Lule Vuniqi
Marta Prekpalaj
Vjosa Dobruna

Përkrahje RRGK

Rrjeti STAR World Learning; Fondacioni Kosovari për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe Agjencioni Kanadez për Zhvillim Ndërkombëtar (CIDA)/ Programi për Iniciativa Lokale të Kosovës (KLIP) sigurojnë përkrahje institucionale dhe ndërtim kapaciteti për RRGK.

Falenderim i veçantë

RRGK shpreh falenderim të veçantë TV21, për përkrahje të jashtëzakonshme për të gjitha aktivitetet e RRGK-së.



"Zëri i Gruas Kosovare" është shkruar nga Elita Gota; redaktuar dhe dizajnuar nga Alison Hyytinen and Nicole Farnsworth.

www.womensnetwork.org

Vazhdim...fushata "Dil e Voto"

Duke qenë se Kosova ka një sistem të veçantë të qeverisjes ku pushteti është i ndarë mes institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse (PSIG) dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), është mjaft e vështirë për qytetarët që të kuptojnë se ku duhet t'i adresojnë problemet e tyre ose këta fajsojnë apo të bëjnë përgjegjës për neglizhencën qeveritare. Kjo kontribuon vetëm në



Studentët vullnetarë janë mbledhur në qendër të Prishtinës për të shpërndarë mesazhin se sa i rëndësishëm është votimi në zgjedhje.

rritjen e frustracionit dhe të cinizmit të qytetarëve. Si rezultat i kësaj situatë, ekspertët parashikuan një numër të ulët votuesish në zgjedhjet e tetorit 2004. Pakënaqësia e votuesve ishte e kuptueshme duke pasur parasysh edhe situatën. Gjithsesi, statusi përfundimtar politik dhe situatë ekonomike e sociale do të përcaktohet këto tre vitet e ardhshme. Ndërsa qeverisja ndërkombëtare dhe ajo vendore luftojnë për pushtet politik, kompetenca dhe statusin e ardhshëm të Kosovës, nevojat reale të qytetarëve janë lënë pas dore. Përveç qëllimit për të rritur numrin e pjesëmarrësve në votime, fushata "Dil Voto" forcoi lidhjet midis votuesve, grupeve të vullnetarëve dhe OJQ-ve, duke rritur kapacitetin e qytetarëve për të marrë pjesë efektivisht në shoqërinë civile kosovare. Duke promovuar vullnetarizmin dhe angazhimin e përditshëm në fushatat e shoqërisë

A DO?

RRYMË?
 UJË?
 RROGË?
 RREGË?
 SHKOLLË?
 STATUS?

MOS U ANKO, VOTO!

"A do? Rrymë, Ujë, Rrogë, Rrugë, Shkollë, Status? Mos u anko, voto," posterë, pamfletë dhe spote televizive shpërndanë mesazhin "Dil e Voto" audiencës së gjerë.

civile, RRGK shpreson të inkuarajojë qytetarët që të marrin më shumë pjesë në shoqërinë civile, si dhe të ngrejë më tepër kapacitetin e qytetarëve dhe grupeve civile për t'u angazhuar në fushata të sukseshme.

UNDP Promovon Raportin e Dytë për Zhvillim Njerëzor në Kosovë

"Promovimi i të drejtave dhe përgjegjësi individuale është një nga praktikat më të mira për zhvillimin e demokracisë dhe të kushteve më të mira jetesore për kosovarët," argumenton Raporti i vitit 2004 për Zhvillim Njerëzor të Kosovës, i cili u promovua më 16 shtator 2004 në Bibliotekën Kombëtare Universitare në Prishtinë. Në promovimin e raportit "Ngritja e Qytetarit: Sfidat dhe Mundësitë" folën përfaqësuesja e UNDP-së znj. Christine Roth, kryeministri Bajram Rexhepi, Kryetari i Shoqatës së Komunave të Kosovës z. Lutfi Haziri dhe Drejtoresha Ekzekutive e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës znj. Igalle Rogova. Raporti për Zhvillim Njerëzor 2004 është botimi i dytë i kësaj natyre në Kosovë. Ai paraqet në mënyrë të detajuar analiza dhe rekomandime për të thelluar qeverisjen demokratike në Kosovë dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës, si dhe zgjidhjet për zhvillim. Për të parën herë ky raport paraqet të dhëna që janë nxjerrë nga komunat. Vlen të theksohet

fakti që pamvarsisht nga progresi i bërë prej 1999, çdo ditë ndihet nevoja të zgjerohen kanalet e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit, si dhe të përkrasin talentet e shoqërisë civile, organizatave, mediave, grupeve të biznesit, si dhe qytetarëve të thjeshtë. Të dhënat e reja ekonomike, sociale dhe politike të raportit tregojnë se si fitimet ose humbjet e këtyre viteve të fundit ndikojnë në zona të ndryshme rajonale, etnike dhe grupet demografike. "Është në

përgjegjësinë e të gjithë kosovarëve që të sigurojnë që qeveria dhe shoqëria civile t'u japë prioritet çështjeve të tilla si ajo e grave me nivel të ulët arsimor, papunësia e të rinjve, minoritetet që kanë frikë për sigurinë e tyre, personat me aftësi të kufizuara dhe të mosshuarit, të cilët kanë nevojë për kujdes personal," shkruhet në këtë raport.

Ky artikull është marrur nga: <http://www.kosovo.undp.org/news/news.asp#16September>.



Raporti i UNDP-së për Zhvillim Njerëzor në Kosovë është lëshuar më 16 Shtator, në Bibliotekën Kombëtare Universitare në Prishtinë. Drejtoresha e RRGK-së Igalle Rogova, Kryeministri Bajram Rexhepi, Përfaqësuesja e UNDP-së Christine Roth dhe Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës Lutfi Haziri (nga e majta në të djathtë) dhanë deklaratat.